

**V E N D I M**  
**Nr.623, datë 31.12.1993**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.345,  
DATË 10.8.1992 "PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS SË PUNONJËSVE"**

Në zbatim të dekretit të Presidentit të Republikës nr.756, datë 14.1.1994 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7583, datë 13.7.1992 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës"", dhe me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.345, datë 10.8.1992, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 paga bazë minimale mujore për punonjësit bëhet 2400 lekë në muaj.

2. Pika 3 ndryshohet si vijon:

"Pagesa mesatare mujore për vitin 1994, për efekt kontrolli, sipas ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore për ndërmarrjet shtetërore dhe institucionet shtetërore jobuxhetore e pjesërisht jobuxhetore të sistemit të tyre është sipas lidhjes që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore kanë të drejtë të rritin deri në 50 për qind pagën mesatare të miratuar për ndërmarrjet e institucionet shtetërore jobuxhetore dhe pjesërisht jobuxhetore të sistemit të tyre, që punojnë me material të porositësit ose ku zbatohet sistemi i punës me akord".

3. Në pikën 10 bëhen këto ndryshime:

Në paragrafin e tretë fjalët "... mbi 5 deri në 30 për qind..." zëvendësohen me fjalët "... mbi 5 deri në 50 për qind...".

Në paragrafin e katërt fjalët "... mbi 30 për qind..." zëvendësohen me fjalët "... mbi 50 për qind...".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 1994.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**